



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr 1012/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala, kryesues, Ymer Hoxha dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Mitrovicë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega Mitrovicë për shkak të parregullsive gjatë ditës së zgjedhjeve për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

AUTORIZOHET kryesuesi i panelit Hasan Shala anëtarë i panelit Muhamet Rexha dhe zyrtari ligjor Adnan Konushevcu që të dalin në vendshiqim në QNR ta bëjnë verifikimin e kutive me nr të votimit 1102X/11R dhe kutise nr 1101B/02D.

Arsyetim

Subjekti politik PDK ka ushtruar ankesë me date 02.12.2013 me pretendim se në vendvotimin nr 1102X/11r është gjetur një fletvotim i falsifikuar dhe se dyshohe se fletvotime të tilla k aedhe në QV të tjera. Për ta vertetuar këtë pretendim ankimor PZAP vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Kryesuesi i panelit

Hasan Shala

